



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 03.06.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, kryetare, Salihe Mustafa, Slavko Simiq
Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, dhe Kujtim Paçaku.

Mungoi: Etem Arifi dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Reshit Gashi, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi,
zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit, UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Berisha-IAP, Sakibe Jashari-Ambasada Zvicerane,
Valmira Rushiti-YIHR-KS, Tetuta Hoxha-YIHR-KS, Leonora Aliu-Koha Ditore, Shehide
Miftari-OSBE, Lejla Selimi-OSBE dhe Arta Xhylani- Praktikante e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve nr.14 dhe 15,
3. Shqyrtimi Raportit të Panelit Rekrutues për Përzgjedhjen e Avokatit të Popullit,
4. Shqyrtimi i Peticioneve,

5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve, nr. 14 dhe 15,

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoj procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me dt.13.05.2015 dhe 14.05.2015 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Raportit të Panelit Rekrutues për Përzgjedhjen e Avokatit të Popullit,

Kryetarja- tha se raportin e Panelit rekrutues për Përzgjedhjen e Avokatit të Popullit, e keni marrur me kohe, meqenëse nuk është arritur të njoftohet me kohe një aplikante, dhe për te evituar gabimin teknik qe ka ndodhur ja kemi mundësuar intervistimin dhe vlerësimin edhe kësaj aplikante.

Mytaher Haskuka-tha se paneli ka mbledhur pikët e intervistimit të aplikantes Brikena Muharemi e cila xhindet në Londër dhe është intervistuar Online, paneli e ka vlerësuar me 55.50 pikë të grumbulluara.

Kryetarja-tha se nga 24 aplikantë që i kanë plotësuar kushtet për intervistim, janë intervistuar 23 aplikant, një ka munguar, intervistimi është zhvilluar në kushte të përshtatshme, nuk ka pasur standarde të dyfishta në pyetjet e shtruara dhe vlerësimit të aplikantëve, kanë pasur kohë prej 20 minutave për përgjigjeje dhe ka qenë kohë e mjaftueshme. Paneli Rekrutues ka vendosur që vlerësimi me pikë i kandidatëve të bëhet në mënyrë të fshehtë.

Anëtarët e Panelit i kanë vlerësuar me pikë aplikantët, pas çdo përgjigjeje në pyetjen e parashtruar .Në fund të intervistimit, anëtarët e Panelit i kanë mbledhur rezultatet për secilin aplikant, për përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara.

Pas përfundimit të procesit të intervistimit, Formulari 1: Vlerësimi i aplikantëve, i cili përmban vlerësimet individuale të panelistëve për secilin aplikant, është hedhur në një kuti, nga secili panelist. Kutia me formularët e vlerësimit është hapur në prani të panelistëve dhe shoqërisë civile.

Rezultatet e vlerësimit janë lexuar në mënyrë të hapur, për secilin aplikant. Rezultatet për secilin aplikant janë shënuar në Formularin 2: Mbledhja e rezultateve. Rezultatet janë mbledhur publikisht.

Kryetarja lexoj rezultatet për secilin aplikant si vijon: Shqipe Ibraj-Malaj 78.14, Isa Hasani 80.57, Milaim Cekaj 53,14, Selim Leka 35.71, Murlan Prizreni 68.57, Naile Alaj

65.42, Afrim Gashi 46.85, Hilmi Jashari 90.28, Isuf Musliu 45.71, Xhavit Shala 58.00, Neshad Asllani 51.71, Atdhe Dema 51.57, Halil Bllaca 76.57, Ramadan Thaqi 52.00, Xhytbehare Murati 69.57, Isuf Sadiku 55.28, Gafurr Podvorica 49.66, Suzan Novoberdaliu 73.50, Shqiprim Pula 78.00, Kaki Krasniqi 42.85, Halim Kuliqi 53.50, Enis Halimi 67.00 dhe Brikena Muharemi 55.50.

Mexhite Mjaku Topalli- tha se beson në punën e panelit dhe falënderon anëtarët e Panelit për punën e bërë, dhe shpreson që kësaj radhe të zgjidhet Avokati i Popullit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-195 për Avokatin e Popullit dhe në nenin 7 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, nr. 04-V-049, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, miratoi Raportin e Panelit rekrutues dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

I. I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për Avokat të Popullit, të radhitur sipas alfabetit të mbiemrit, si vijon:

- | | |
|----------------------|-------------|
| 1. Isa Hasani | 80.57 pikë |
| 2. Shqipe Ibraj-Mala | 78. 14 pikë |
| 3. Hilmi Jashari | 90.28 pikë |

4.Shqyrtimi i Peticioneve,

Kryetarja –tha se për shqyrtimin e petitionit të Zahrije Podrimqakut udhëheqëse e grupit është deputetja Valdete Bajrami, dhe meqenëse deputetja mungon propozoj që ky petition të mos shqyrtohet në këtë mbledhje.

Kryetrja-për petitionin e punëtorëve të Hotelit Grand ja dha fjalën deputetes Teuta Haxhiu.

Teuta Haxhiu- tha se e kam shikuar përgjigjen që e ka kthyer Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe i kam dilemat në këtë shkresë, është mirë që ne ta kemi materialin që i ka shkua Komisionit për Zhvillim Ekonomik, pastaj thuhet se kontratat e gjithë punëtorëve janë vazhdu fillimisht, pastaj në pjesën tjetër thuhet se ju janë anulua. Ne si komision të kërkojmë informata shtesë ,në radhe të parë atë shkresë që i ka ardh komisionit, informata shtesë nga sindikata e punëtorëve të Hoteli Grand se a janë të sakta këto informata, se

kontratat e punës ju janë vazhdu apo jo, nga ato që na janë thënë në takimin e fundit neve në komision është krejt diçka e kundërta. Ajo tha se agjencioni me mungese të stafit është duke e kryer një pune jo ligjore dhe deri sa nuk janë komplet puna e këtij agjencioni të privatizimit duhet të ndërpritet, ka informacione se agjencioni për qëllime të veta po i ngulfat ato biznese që janë aty.

Salihe Mustafa- tha se kishte me qenë mirë që komisioni i ynë me Komisionin për Zhvillim Ekonomik me mbajtur një takim të përbashkët dhe besoj që pas kësaj të dalim me një qëndrim më të drejtë.

Mytaher Haskuka-tha se nuk po mundem me kuptu sepse në njërën anë thuhet se janë vazhduar kontratat, në një vend tjetër thuhet se nuk mund të vazhdohen kontratat sipas procedurave, dhe nuk është e kuptueshme se çka ka ndodhur në të vërtetë, pajtohem që të thirret Komisioni për Zhvillim Ekonomik, përfaqësuesit e Sindikatës së Punëtorëve të Hoteli Grand dhe përfaqësuesit e AKP-së, te na sqarojnë çka është bërë në kërkesën e peticionit të punëtorëve të Grandit dhe pastaj të merret një vendim.

Kryetarja- tha se po del që na duhen më shumë informata dhe grupi punues të mbetet në kontakt me komisionin për Zhvillim Ekonomik, përfaqësuesit e Sindikatës së Punëtorëve të Hotelit Grand dhe Përfaqësuesit e AKP-së, por na duhet edhe një ekspert ligjor për ta vlerësuar këtë lëndë.

Teuta Haxhiu- propozoj që në takim me Komisionin për Zhvillim Ekonomik , AKP dhe përfaqësuesit e Sindikatës së Hotelit Grandit të jetë komplet Komisioni pasi që është një çështje e ndishme shqyrtimi i këtij Peticioni, sepse ka kunderthenie mes veti brenda për brenda kësaj shkrese.

Kujtim Paçaku- tha se lënda është mjaft komplekse dhe krahas ekspertit ligjor duhet të jetë edhe një ekspert nga fusha e ekonomisë dhe prej të gjitha palëve të përfshira duhet të kemi të dhënat me shkrim, sepse kjo do të na ndihmonte shumë për të marre një vendimi i cili është mjaft kompleks.

Salihe Mustafa-tha se ndoshta është më mirë me shkua si grup punues dhe kush është i interesuar prej komisionit, sepse dyshoj qe kur e bëjmë si mbledhje te komisionit kemi mu mundu me bërë fjalë më shumë e qëllimi im është me ju ndihmu puntoreve.

Kryetarja- tha se propozoj takime të ndara, tha se përveç shkresës që e kemi bere unë kam zhvillu biseda edhe me kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, dhe se përfaqësuesit e AKP-së dhe të Peticionit i kemi takuar një herë por është mirë ti dëgjojmë edhe njëherë me qëllim vetëm me lehtësuar punën, kjo të behet nga grupi punues dhe kush është i interesuar të marrë pjesë sepse njoftimi do tu shkojë të gjithëve.

5.Të ndryshme

Mytaher Haskuka-tha se për monitorimin e Ligjit për Personat e Verbër ka pasur disa takime individuale me disa organizata dhe kur të behet raporti është mirë me i diskutua disa nga çështjet që i kanë ngritur ata dhe me i përfshi në raport.

Salihe Mustafa-tha se vizitat për monitorimin e këtij ligji kanë përfundua dhe është duke u punuar raporti, dhe pastaj vjen në komision dhe aty edhe mundet mu plotësua dhe mu diskutua sikur te gjitha çështjet e tjera.

Mexhide Mjaku-Topalli- tha se është mirë me përfundua udhëzuesi për peticione sepse është punua në të dhe të përfundohet.

Kryetarja- tha se kjo mbetet mu perfundu por për shkak tëdisa çështjeve të ngutshme që i kemi pasur nuk kemi pasur mundësi me përfundua udhëzuesin.

Lejla Selimi OSBE- tha se mundemi me vazhdua edhe me një punëtori për Udhëzuesin për Shqyrtimin e Peticioneve për ta përfunduar këtë udhëzues, por për organizimin e kësaj na nevojiten 3 javë kohë.

Kryetarja-tha se e shiqojmë mundësinë se kur na konvenon dhe pastaj vendosim se kur të mbahet puntorija .

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Lirije Kajtazi